

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ KPT Company ” SH.P.K

Ne baze te ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”
“UNE” ortaku i poshteshenuar :

- 1- **RIGERS LOKA** atesia Artur lindur me dt.06.06.1998 ne Tirane, dhe banues ne adresen
“Rruga Sul Gjashta, Allias, Ap 14 Tirane, Shqiperi, madhore e me zotesi te plote per te
vepruar, e identifikuar me leternjoftimin ID nr.036784640 dhe numer personal
J80606046D
me vullnetin tim te lire e te plote themeloj me ane te ketij statusi shoqerine ” **KPT
Company” SH.P.K me 1-(nje-ortak)** sipas dispozitave ligjore te shprehura me poshte
ne baze te ligjit 9901 Dt.14.04.2008.

KREU I

THEMELIMI, EMRI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA,SELIA,ADRESA NE INTERNET

Neni 1

Themelimi dhe Emri i Shoqerise

Sot ne date 09/09/2021, ne Tirane, “UNE” ortaku i lartpermendur kam themeluar shoqerine
tregtare me pergjegjesi te kufizuar ” **KPT Company ” SH.P.K me 1-(nje-ortak)** me SELI
QENDRORE ne adresen Rruga Jordan Misja, Dyqani Nr 10-11-12-13 **Tirane**

Neni 2

Objekti i Shoqerise

Shoqeria tregtare ” **KPT Company ” SH.P.K** , do te kete si objekt te veprimtarise se saj :
“Veprimtari ne fushen elektronike digitale, elektrike , krijimi I skemave elektrike , rrjete
kompiuterike dhe elektronike , implementimi I softwear, shitja e pajisjeve kompiuterike, krijimi
I faqeve web , marketing ne rrjetet sociale, krijimi I llogarive ne rrjetet sociale dhe mirembajtjen
e tyre, menaxhimin i Web, reklamim ne rrjete sociale te rekrutimit te punonjesve,panelet
elektronike , bashkepunim nderkombetar ne fushen elektronike, komunikimit online dhe te
krijimit te desing , marketing digital, sherbimin per krijimin e kontentit digital, etj.

Neni 3

Kohezgjatja e Shoqerise

Shoqeria do te kete nje afat te papercaktuar ne veprimtarine e saj . Personalitetin juridik shoqeria
e fiton pas rregjistrimit ne QKB , date e cila do shenoje dhe fillimin e veprimtarise se saj.

Neni 4

Selia qendrore , vendi dhe adresa e Internetit

Selia qendrore e shoqerise, me te cilin do te pajiset me Nipt/Nuis kryesor nga Qkb-ja, do te
jete ne adresen adresen: Rruga Jordan Misja, Dyqani Nr 10-11-12-13 **Tirane**

. Shoqeria ne baze te ligjit ka te drejte te hape zyra perfaqesimi ose dege te saj ne te gjithe
territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit, duke ju nenshtruar legjislacionit te
vendit perkates. Shoqeria gjate veprimtarise se saj ka te drejte qe te kete maredhenie edhe me
shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja, brenda dhe jashte vendit, te beje bashkepunime me to ne
baze te ligjeve shteterore dhe atyre nderkombetare. Shoqeria ka dhe adresen e saj ne internet qe
eshte rigers.loka@gmail.com

KREU II

Neni 5

Kapitali i Rregjistruar i Shoqerise

Kapitali i rregjistruar i shoqerise eshte **100,000 (njqind-mije)** leke dhe perbehet nga "1" (nje) kuote/pjese. Ortaku i shoqerise zoteron "1" kuote dhe kapitali i shoqerise zoterohet teresisht nga 1-ortak. Ortaku i vetem Rigers Loka zoteron "1-nje kuote 100% te kapitalit themeltar te shoqerise dhe ka kontribuar me 100,000(njqind mije) Pas rregjistrimit ne QKB dhe fitimit te personalitetit juridik, shoqeria ka te drejte te perdore kapitalin e rregjistruar per fillimin e veprimtarise se saj. Shoqeria mund te marre hua financiare nga ortaket, ose persona te trete fizik ose juridik institucione Bankare vendas ose te huaj, ne perputhje me ligjin e brendshem ose ate nderkombetar, per te plotesuar vleren financiare nese kapitali financiar eshte i pamajftueshem per fillimin e aktivitetit.

Neni 6

Certifikata dhe rregjistri i KUOTAVE

Ortaku/ket themelues , sipas kontributit ne kuotat e kapitalit themeltar pajisen me Certifikaten e Kuotave leshuar nga shoqeria menjehere pas fitimit te personalitetit te saj juridik pas rregjistrimit ne QKB. Kuotat e shoqerise rregjistrohen ne "Rregjister" me vleren e tyre, rregjister qe administrohet nga administratori i shoqerise gjate gjithe mandatit te tij ligjor te vendosur ne ligj dhe ne kete Statut . Ne kete rregjister behen shenimet perkatese ne rast te tjetersimit teresisht ose pjeserisht te koutave te kapitalit themeltar te shoqerise ose kur kouta te caktuara zoterohen bashkarisht nga disa ortak.

Neni 7

Kalimi i KUOTAVE

Kalimi ose tjetersimi i kuotave te kapitalit themeltar te rregjistruar te shoqerise mund te behet me anen e shitblerjes , dhurimit, trashegimit ose cdo menyre tjeter te perashikuar ligjerisht. Ne rastet e shitblerjes apo dhurimit nenshkruhet kontrata perkatese ne baze te dispozitave ligjore. Kur shoqeria zoterohet me dy ose me shume ortak, Secili prej ortakeve eshte i detyruar te marre pelqimin e ortakut tjeter para se te bej kalimin e pjeses se tij te kuotave tek nje person tjeter fizik ose juridik qe pretendon te hyje si ortak i ri ne shoqeri. Ne rastet kur nje ortak vdes, atehere kuotat e tij trashegohen ne baze te ligjit per shoqerite tregtare dhe te dispozitave ligjore per trashegimime nga pasardhesit e tij sipas radhes ligjore ose testamentit. Trashegimtari i kuotave pasi i ka paraqitur administratorit dokumentat provuese si trashegimtar, ka te drejte te kerkoje nga administratori rregjistrimin e emrit te tij si ortak ne rregjistrin e kuotave te shoqerise. Sido qe te jete menyra e kalimit te kuotave, Administratori ne cdo rast ben shenimet perkatese ne rregjistrin e aksioneve.

Neni 8

Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit te shoqerise

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë. Asambleja e Ortakeve merr vendimin perkates ne baze te dispozitave te ligjit tregtar, ku vendos per shumen me te cilen do te rritet kapitali dhe autorizon administratorin te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per kete qellim. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Zvoglimi

i kapitalit te shoqerise behet me vendim te asamblese dhe ne cdo rast jo me pak se 100.000(njeqind- mijë) leke sipas kushteve ligjore te parashikuara ne ligj. Ne cdo rast zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit behet me nje raport te detajuar te ekspertit kontabel dhe rregjistrohet ne QKB. Asambleja e ortakeve vendos per rritjen apo zvoglimin e kapitalit mbasi eshte konsultuar me ekspertin kontabel ne baze te nje raporti te detajuar te tij, si dhe me administratorin.

KREU III
ORGANET DREJTUESE
Asambleja , Administratori/et
Neni 9
Asambleja

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e ortakeve, mblidhet ne menyre te zakonshme te pakten 2-here ne vit. Mbledhja thirret nga te pakten njeri prej ortakeve ose dhe nga administratori. Njoftimi behet te pakten 7-dite para dates se caktuar per mbledhje me ane te faxit, telefonit fix apo cel, e-mailit, postes etj.

Asambleja (ortaku) merr vendime dhe ka kompetenca per :

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; per investime;
 - vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 - përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - ndryshimet e statutit;
 - emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur me lart
 - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ne raste te caktuara kur nje nga ortaket mungon ai mund te perfaqesohet sipas rregullave ligjor te perfaqesimit nga nje person i zgjedhur prej tij.

Neni 10
ADMINISTRATORI

ADMINISTRATORI i emeruar i shoqerise me vendim unanim te asamblese se ortakeve eshte Zoti **RIGERS LOKA**. Afati i emerimit te tij eshte **3-vite** me te drejte rizgjedhjeje. Ky afat fillon ne date 09/09/2021 dhe mbaron ne date 08/09/.2024. Administratori emerohet dhe shkarkohet me shumice votash nga asambleja e ortakeve. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet qe të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare, kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori i shoqërisë ka të drejte të kryejë veprime financiare në të gjitha Bankat ku Shoqëria ka llogari Bankare, deri në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë leke ose e konvertuar kjo me monedhen e huaj sipas kursit të Bankës së Shqipërisë. Mbi këto shume ai ka detyrimin të marrë pelqimin e Asamblese së Ortakeve e cila vendos me shumice të thjeshte. Administratori në bazë të ligjit mund të delegojë një ose disa kompetenca të veprimtarisë së tij tek një person tjetër me anë të autorizimit ose prokures, pasi të ketë marrë pelqimin e shumicës së thjeshte të asamblese së ortakeve. Çdo veprim i tij në kundërshtim me këto dispozite e ngarkon administratorin me përgjegjësi ligjore.

Administratori është personi që përfaqëson shoqërinë me të tretet dhe specimenti i nënshkrimit të tij është si më poshtë :

Specimenti / nënshkrimi (emer, mbiemer, firme)
--

Neni 10

Emerimi I ekspertit kontabel

Asambleja e shoqërisë cakton një ose disa eksperte kontabel që mund të jenë persona fizik ose juridik, **ne rastet e kerkuara nga ligji**. Mandati i ekspertit kontabel është **3-vjet** me të drejtë rizgjedhjeje. Emerimi dhe largimi i ekspertit bëhet me vendim të asamblese me shumice të thekshte. Eksperti kontabel ka detyrimin të raportojë ecurinë financiare të shoqërisë dhe të bejë sugjerime për rentabilitetin e veprimtarisë së shoqërisë. Eksperti kontabel ka të drejtë të bejë kontrole periodike të aktivitetit të shoqërisë dhe të raportojë për këto tek ortaket ose administratori. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1- Janar dhe përfundon me 31 -Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor. Eksperti kontabel mban një raport të detajuar në mbylljen e vitit ushtrimor fiskal dhe është përgjegjës për mbylljen e bilancit të shoqërisë dhe ndarjen e dividendit. Dividendi shpërndahet mes ortakeve, në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, dhe kuotat e secilit ortak.

Neni 11

Dividentet dhe shpërndarja e tyre.

Shpërndarja e dividendit bëhet pas raportit financiar të ekspertit për mbylljen e vitit ushtrimor financiar, bilancit. Shpërndarja bëhet me vendim të ortakut ose të asamblese në përputhje me ligjin. Shpërndarja e dividendit bëhet në raport me pjesëmarrjen e ortakut-ve në kuotat e kapitalit të regjistruar. Një pjesë e dividendit të pashpërndarë, me vendim të asamblese mund të kalojë në kapitalin themeltar.

Neni 12
Riorganizimi , Prishja dhe likuidimi I shoqerise

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 dt. 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” Në rastet e prishjes dhe të likuidimit të shoqërisë para afatit të mesiperm vendos mbledhja e përgjithshme e asamblese së ortakëve. Likuiduesi mund të shpërndajë të ortaku-et të gjitha pasuritë e deri në atë moment që posedon në pronësi shoqëria. Prishja mund të vijë edhe si pasoje e falimentimit të shoqërisë. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e ortakëve ose ortaku i vetëm. Nëse asambleja nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Likuiduesi emërohet nga Gjykata në rastet kur shoqëria prishet me vendim gjykatë. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakut-ve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon cregjistrimin e shoqërisë.

Neni 13
Dispozita te Fundit

Ky “Statut” është mbështetur teresisht në ligjin 9901 dt. 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” . Për të gjitha rastet të cilat nuk janë parashikuar në statut do të gjejnë zgjidhje dhe interpretohen sipas këtij ligji. Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të jetë kompetente Gjykata Kompetente Shqiptare.

“Statuti” është përpiluar në 4-kopje origjinale me fuqi të njëjtte ligjore, në gjuhën SHQIPE sipas kërkesave të ligjit. Përmbajtja e STATUTIT pasi lexohet dhe kuptohet përfundimisht mesemiri nga të gjithë ortakët e shoqërisë, gjendet në përputhje me vullnetin e tone të plote dhe ortaku/et e sipershënuar e nënshkruajme pa asnjë vërejtje.

THEMELUESIT E SHOQËRISË “ KPT Company ” SH.P.K

RIGERS LOKA
Rigers Loka

